

Editorial

DEKLARATË E LIGËS SË BOTËS ISLAME NË LIDHJE ME FILMIN QË PREK PERSONALITETIN E PROFETIT a.s.

Me Emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit



L avdërimet i takojnë Allahut, paqja dhe bekimi i Tij qoftë për Profetin tonë, të Dërguarin e Allahut Muhamed, për familjen dhe shokët e tij dhe të gjithë ata që e ndjekin atë.

Këshilli Botëror i Dijetarëve Muslimanë, pranë Ligës së Botës Islame, ka ndjekur me shqetësim veprimet e disa ekstremistëve koptë të Amerikës, të cilët kanë prodhuar së fundi një film, i cili cenon personalitetin e Profetit tonë Muhamed (paqja e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi të) të mbështetur edhe nga ekstremisti Samuel Bacil dhe priftit ekstremist Teri Xhons, ku ky i fundit pak kohë më parë ka djegur edhe publikisht një kopje të Kuranit të nderuar.

Ne dënojmë me forcë këtë veper të shëmtuar dhe e konsiderojmë atë krim monstruo, ndaj të cilit nuk mund të heshtet. Liria e shprehjes nuk duhet të cenohet fetë, vlerat dhe shenjtëritë, në përputhje kjo me normat ndërkombëtare dhe marrëveshjeve të rëna dakord në konferencat e dialogut ndër-fetar dhe atij kulturor...

Muslimanët sot përbëjnë një të pestën e banorëve të botës dhe shtetet ku ata jetojnë mbajnë marrëdhënie të mira me shtetet e tjera të botës, në mes tyre edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe nuk është në interes të askujt, që muslimanët të provokohen duke cenuar besimin, fenë dhe Profetin e tyre, nga një grup ekstremistësh, që si objektiv të tyre kanë nxitjen e trazirave dhe ripërtëritjen e thirrjes për përplasje qytetërimësh.

Ne e vlerësojmë deklaratën e bërë nga Kisha Kopte e Egjiptit dhe organizatat e tjera kopte nëpër botë, të cilat shprehën qartazi refuzimin e tyre ndaj cenimit të fesë Islame dhe Profetit të saj Muhamed (paqja e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi të).

Duke ritheksuar edhe njëherë pozitën madhështore të Profetit Muhamed (paqja e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi të), ne u kujtojmë njerëzve se gjatë gjithë historisë njerëzore, armiqtë e mesazheve hyjnore dhe të Profetëve, nuk kanë hequr dorë nga cenimi i personaliteti të tyre, e këtu

nuk bën përjashtim as Vula e Profetëve dhe i Fundit i tyre, Muhamedi (paqja e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi të). Profeti ynë gëzon një pozitë të lartë, të cilën vetë Zoti i Lartësuar ka marrë përsipër ta ruaj nga cenimet e keqbërësve duke thënë: "Ne të mjaftojmë ty kundër atyre që të tallin" dhe duke i kërcënuar ata me fjalën e Tij: "Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë."

Duke dashur që t'i jepet fund sulmeve të ulëta ndaj Islamit dhe kumtuesit të mesazhit të tij, Muhamedit (paqja e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi të), ne kërkojmë si vijon:

Së pari: Të gjykohen prodhuesit e filmit, në përputhje kjo me normat dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe të mos mjaftohet vetëm me distancime dhe dënime, kjo sepse vepra në fjalë bie ndesh qartë me rezolutën e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara të datës 20/03/2008 rreth respektit ndaj feve, mos cenimit të fesë islame dhe refuzimit të çdo lloj cenimi të figurës dhe personalitetit të Profetit Muhamed.

Së dyti: Ne i ftojme qeveritë dhe organizatat islame nëpër botë, që të vendosin strategji të qarta, për tu përballur me këto sulme ndaj Islamit dhe Profetit të tij. Liga e Botës Islame është e gatshme të koordinojë ndërmjet organizatave islame për këtë çështje.

Së treti: Ne u bëjmë thirrje muslimanëve në mbarë botën, që të thellohen në studimin e jetës së Profetit (paqja e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi të) dhe t'ua mësojnë atë edhe fëmijëve të tyre dhe të udhëhiqen në jetë nga mësimet dhe morali i tij i lartë: "ti me të vërtetë je me virtyte madhore." (Kurani 68:4)

Së katërti: U bëjmë thirrje muslimanëve që t'u largohen qëndrimeve të nxituara dhe reagimeve spontane, ata duhet të sillen me provokimet dhe sulmet (anti-islame) ashtu siç na mëson Profeti ynë (paqja e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi të), duke iu përgjigjur atyre me urtësi, e cila nuk na lejon që ne si muslimanë të tejkalojmë cakun e së drejtës, apo të çënojmë jetën dhe pasurinë e njerëzve dhe të sulmojmë ambasadat e huaja me pa të drejtë: "dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit." (Kurani 6:164)

Së pesti: Islami ua ndalon muslimanëve të vrasin njerëz me pa të drejtë, që do të thotë se ata e kanë obligim të mos prekin jetën e njerëzve: "kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve." (Kurani 5:32)

Ne i bëjmë thirrje çdo muslimani, që

të vërë në praktikën e jetës së tij udhën islame dhe modelin e Vulës së Profetëve dhe të distancoj veten nga agresioni kundër shtetasve të vendeve të tjera dhe ambasadorëve të tyre, në mënyrë që të mos u jap shkas armiqve të Islamit të përfitojnë nga reagimet spontane e të pakontrolluara që të shtrembërojnë figurën e Islamit.

* Ky qëndrim i Ligës së Botës Islame përfaqëson edhe qëndrimin zyrtar të LIDHJES SË HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË, si anëtare e kësaj organizate që prej vitit 2011.

<http://www.themwl.org/News/default.aspx?ct=1&cid=8&nid=1297&l=AR>

KA THËNË PROFETI **MUHAMED** ALEJHI SELAM

■ ■ SHFRYTËZONI PESË GJËRA PARA PESË TË TJERAVE:

RININË PARA **PLEQËRISË,**

SHËNDETIN PARA **SËMUNDJES,**

PASURINË PARA **VARFËRISË,**

KOHËN E LIRË PARA **SE TË JESH I ZËNË**

JETËN PARA **VDEKJES"** ■ ■

HADITH

LHSH **MBLEDH ZEKATIN TUAJ**

Për zekatin në lekë:
 IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
 Llogaria në lekë:
 IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
 Llogaria në Euro:
 IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
 Llogaria në Dollarë:
 IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
 Tel: 0672304520 / 0672538334 / 048320160
 BKT Banka Kombëtare Tregtare
 Nr. i llogarisë : 52416329

Fq.3/ Urtësia e Përjetshme dhe e Vërteta e të Përbashkëtës Njerëzore

Nga Fejsal ibn ALI EL-KAMILI

Fq.5/ Simpozium / Islami fe e mesatarisë "Praktikimi i Islamit mesatar në jetën e

Nga Bekir HALIMI

Fq.7/ Dalja jashtë dyerve të xhamisë për rritjen e ndërveprimit publik

Nga Roland ZILI

Fetva/ SUBJEKTI: TRANSPLANTIMI I ORGANEVE TË TRUPIT

**Akademia e Fikhut Islam me
qendër në Mekë**

Lavdërimi i takon vetëm Allahut, Lpaqja dhe bekimi i Tij qoftë për Profetin tonë, pas të cilit nuk vjen profet tjetër.

Asambleja e Akademisë që Fikhut Islam në sesionin e saj të tetë të zhvilluar në Mekën e nderuar në qendrën e Ligës së Botës Islame, nga data 28 Rebiul Ahar 1405 h – 7 Xhumadil Ula 1405 h. / 19-28 Janar 1985 e.s. mori në shqyrtim çështjen e transplantimit të disa prej organeve të trupit të marra nga një njeri për te një tjetër, ku ky i fundit ka nevojë të domosdoshme për të për të zëvendësuar atë që tek ai ka dalë jashtë funksionit. Padyshim që transplantimi i organeve është një nga sukseset e rëndësishme të mjekësisë bashkëkohore si dhe të avancimit të mjeteve të përdorura. Akademia e Fikhut Islam në këtë rast i përgjigjet pyetjes që i është drejtuar asaj nga zyra e Ligës së Botës Islame në SHBA.

Akademia mori në shqyrtim studimin e paraqitur nga Prof. Shejh Abdullah ibn Abdurrahman Al-Basam rreth kësaj teme, në të cilin ai sqaronte mospajtimin që ekziston në mes dijetarëve të sotëm për këtë çështje, nëse lejohet transplantimi apo jo, si dhe argumentet fetare të secilit grup. Pas një diskutimi të gjerë ndërmjet anëtarëve të Asamblesë së Akademisë, Asambleja është e mendimit se argumentet e atyre që lejojnë transplantimin janë më të pranueshme, kështu që ajo vendosi si më poshtë:

Së pari: Marrja e një organi nga një njeri i gjallë dhe vendosja në trupin e një njeriu tjetër, i cili gjendet në një situatë domosdoshmërie dhe i shpëton atij jetën apo i kthen atij një nga funksionet bazë të saj, është një vepër e lejuar dhe nuk bie ndesh me fisnikërinë e njeriut që i është marrë kjo pjesë. Kjo vepër gjithashtu ka një dobi të madhe dhe një përfitim të pallogaritshëm për njeriun që përfiton nga ky transplantim dhe si e tillë ajo është një vepër e lejuar dhe e lavdëruar nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

1. Duhet që organi që merret nga dhuruesi të mos i shkaktojë atij dëm të atillë që i prish normalitetin e jetës, sepse një nga rregullat e Sheriatit thotë “Nuk lejohet që dëmi të largohet me një dëm të ngjashëm apo më të madh se ai”. Në këtë rast një dhurim i tillë do të ishte një vetëvrasje, gjë që nuk lejohet nga feja.

2. Duhet që dhurimi të jetë i lirë nga njeriu që e dhuron dhe jo i imponuar.

3. Duhet në këtë rast që transplantimi i këtij organi të jetë i vetmi mjet mjekësor i mundshëm, që kuron të sëmurin në gjendjen e

jashtëzakonshme ku ai ndodhet.

4. Duhet që operacioni i marrjes dhe i transplantimit të ketë garanci të plotë apo të madhe se është i suksesshëm.

Së dyti: Rastet e mëposhtme janë të lejuara nga ana fetare:

1. Lejohet marrja e një organi nga një njeri i vdekur për të shpëtuar një njeri tjetër i cili ka nevojë të domosdoshme për të, me kusht që njeriu nga i cili merret ky organ të jetë i përgjegjshëm dhe ta ketë lejuar këtë gjë gjatë kohës që ai ishte akoma gjallë.

2. Lejohet marrja e organit nga çdo kafshë që theret dhe lejohet ngrënia e saj, ose edhe të tjera në raste domosdoshmërie, për tu transplantuar te njeriu që ndodhet në gjendje domosdoshmërie.

3. Lejohet marrja e një pjesë nga trupi i vetë personit për të riparuar një pjesë tjetër të tij, si p.sh. marrja e një pjesë të lëkurës apo kockës së tij, nëse diçka e tillë është e nevojshme.

4. Lejohet të vendosen në trupin e njeriut pjesë të prodhuara artificialisht qofshin këto metale apo diçka tjetër, për ta kuruar atë nga sëmundja apo defektet, si p.sh. në nyjat e kockave, valvulin e zëmrës etj.

Në të katër këto raste Asambleja është e mendimit se lejohet fetarisht transplantimi duke iu përmbajtur kushteve të përmendura më sipër.

Gjatë diskutimit të kësaj çështje morën pjesë edhe këta mjekë:

1. Dr. Sejid Muhamed Ali El-Bar
2. Dr. Abdullah Baselameh
3. Dr. Halid Emin Muhamed Hasan
4. Dr. AbdulMabud Amareh Es-sejid
5. Dr. Abdullah Xhumah
6. Dr. Gazi El-haxhim

Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë për Profetin tonë Muhamed, familjen dhe shokët e tij. Lavdërimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve.

<http://www.themwl.org/Fatwa/default.aspx?d=1&cid=99&l=AR&cid=12>

SUBJEKTI: VDEKJA DHE SHKËPUTJA E APARATEVE TË REAMINIMIT NGA TRUPI I NJERIUT

Lavdia i takon Allahut, paqja dhe bekimet e Tij qofshin për Profetin tonë Muhamed, pas të cilit nuk ka profet tjetër, për familjen dhe shokët e tij.

Asambleja e Akademisë së Fikhut Islam, në Sesioni e saj të dhjetë të mbajtur në Mekën e nderuar nga data

24 Sefer 1408/ 17 Tetor 1987 deri në datën 28 Sefer 1408/ 21 Tetor 1987 mori në shqyrtim temën: Raporti i vërtetimit të vdekjes nëpërmjet shenjave mjekësore të sigurta si dhe lejimi i heqjes së aparatave të reaminimit, nga i sëmurit që ndodhet nën përkujdesje të përqendruar.

Asambleja u njoh me opinionet dhe sqarimet mjekësore, të paraqitura me gojë dhe me shkrim, nga Ministria e Shëndetësisë së Arabisë Saudite dhe nga mjekë specialistë, po kështu edhe me vendimin e Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut Islam nën vartësi të Organizatës së Konferencës Islamike, të mbledhur në Aman të Jordanisë nr. 5 datë 3/7/1986 e.s.

Pas diskutimit të çështjes nga të gjitha aspektet dhe problematikat që mbart Asambleja morri këtë vendim:

Të sëmurit të cilit i janë vendosur në trup aparatet e reaminimit, lejohet që ato t'i hiqen, nëse pushojnë së funksionuari përfundimisht të gjitha funksionet nervore të tij dhe nuk ka më kthim mbrapa, edhe nëse zemra dhe frymëmarrja e tij vazhdojnë të funksionojnë automatikisht me anë të aparateve që i janë vendosur në trup, por heqja e tyre bëhet kur këtë e vendos një komision prej tre mjekësh specialistë me përvojë.

Por megjithatë, nuk gjykohej fetarisht për të se ka ai vdekur, vetëm pasi t'i ketë ndaluar plotësisht frymëmarrja dhe zemra, pas heqjes së aparatave.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin për Profetin tonë Muhamed, për familjen dhe shokët e tij.

<http://www.themwl.org/Fatwa/default.aspx?d=1&cid=113&l=AR&cid=12>

FEKONDIMI ARTIFICIAL (IN VITRO)

**Akademia Ndërkombëtare e
Fikhut Islam /Vendimi nr. 16 (4/3)/**

Asambleja e Akademisë së Fikhut Islam e mbledhur në sesionin e saj të tretë në Aman, kryeqytetin e Mbretërisë Jordaneze Hashimite në datat 8-13 Sefer 1407 h. /11-16 Tetor 1986 e.s. pasi mori në shqyrtim studimet e paraqitura rreth fekondimit artificial (in vitro) dhe dëgjoi shpjegimin e mjekëve specialistë, iu bë e qartë se sot për sot kemi të bëjmë me shtatë forma të njohura të fekondimit artificial, si

rezultat Asambleja mori këtë vendim:

SË PARI: Pesë format e mëposhtme janë të ndaluara fetarisht, të ndaluara kategorikisht për shkak të vetë formës ose për shkak të pasojave, siç është përzjerja e prejardhjes, humbja e mëmësisë si dhe anë të tjera fetarisht negative:

forma e parë: merret fara e mashkullit dhe fekondohet me vezën e një gruaje që nuk është gruaja e tij dhe më pas vendoset në mitrën e gruas së tij.

forma e dytë: merret veza e gruas dhe fekondohet me farën e një mashkulli që nuk është burri i saj dhe më pas vendoset në mitrën e kësaj gruaje.

forma e tretë: merret veza dhe fara e dy bashkëshortëve dhe pasi fekondohen jashtë në mënyrë artificiale kjo vendoset në mitrën e një gruaje tjetër që del vullnetare për këtë gjë.

forma e katërt: merret veza e një gruaje të huaj dhe fekondohet me farën e një burri të huaj dhe më pas kjo vendoset në mitrën e bashkëshortes.

forma e pestë: merret veza e bashkëshortes dhe fekondohet jashtë me farën e bashkëshortit dhe më pas vendoset në mitrën e bashkëshortes tjetër (në këtë rast burri ka më shumë se një grua).


SË DYTI: Dy format e tjera të fekondimit artificial janë të lejuara, nëse paraqitet nevoja për to, por me kushtin e domosdoshëm që të merren të gjitha masat e duhura për të ruajtur procesin, këto forma janë:

forma e gjashtë: merret fara e burrit dhe veza e gruas së tij dhe kryhet fekondimi i jashtëm, më pas ajo vendoset në mitrën e gruas.

forma e shtatë: merret fara e burrit dhe vendoset në një vend të përshtatshëm brenda organit gjental të gruas së tij ose në mitrën e saj duke kryer kështu një fekondim të brendshëm.

Allahu e di më së miri.

Revista e Akademisë nr. 3 vol. 1 fq. 423
www.fiqhacademy.org.sa



Bordi botues:
Justinian TOPULLI
Genc PLUMBI
Mustafa TERNIQLI

Redaktor përgjegjës
Roald A. HYSA

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: Teodor Keko mbi Alfa Bank, Tirane-Shqiperi
lidhjahoxhallareve@yahoo.com

Tel & Fax: +355 (0)48320160

<http://www.lidhjahoxhallareve.com>

Urtësia e Përrjetshme dhe e Vërteta e të Përbashkëtës Njerëzore

Nga Fejzal ibn Ali el-Kamili

“Urtësia e Përrjetshme” është një filozofi mistike që thotë se, të gjitha traditat fetare për gjatë kohërave janë shfaqje të ndryshme të një të vërtete të vetme dhe se, njohuritë fetare, pavarësisht dallimeve mes tyre, burojnë nga një thelb i vetëm ose nga “feja e përrjetshme” (Religio Perennis). Të gjitha fetë, pavarësisht nga konteksti i tyre kulturor apo historik, janë thjesht interpretime të ndryshme të kësaj të vërtete universale të përbashkët. Dallimet në mes librave të shenjtë që u përkasin feve të ndryshme dhe mospërputhjet mes tyre, vijnë për shkak se çdo fe është formësuar në trajta të ndryshme për tu përshtatur me nevojat shoqërore, racionale dhe shpirtërore të epokës kur ato janë shfaqur. Duke u bazuar në këtë pikëpamje, dallimet në mes feve, si ndjekësit e kësaj filozofie, shihen si lëvizje (ana e jashtme) të cilat mund të largohen për të mbërritur te thelbi (ana e brendshme).

I pari ai që ka përdorur shprehjen “urtësia e përrjetshme” apo “filozofia e përrjetshme” ishte katoliku humanist Agostino Steuco (1497–1548 e.s.). Steuco punoi si sekretar i zyrës së Vatikanit dhe në vitin 1540 e.s. shkroi një libër me titullin “Filozofia e Përrjetshme” të cilin ia dhuroi papës Pali i tretë. Ndërkohë ky term ka gjetur përhapje të madhe në kohën moderne, pas botimit të librit me titull “Filozofia e Përrjetshme” (The Perennial Philosophy) të filozofit Aldous Huxley në vitin 1945 e.s.

Shkolla më e njohur e mendimit që bazohet mbi këtë filozofi ezoterike është ajo që quhet “Shkolla e Traditës”, të cilën e përfaqësojnë mjaft mendimtarë të shek. XX, si Rene Guenon, Martin Lings dhe iraniani S. Husein Nasr.

Shkolla ka marrë këtë emër “Traditionalism”, sepse sipas pretendimit të saj ka një “trashëgimi” të përbashkët ndërmjet të gjitha feve: Hinduizmit, Budizmit, Judaizmit, Krishterimit, Islamit... etj. Kjo trashëgimi e përbashkët i ngjan qendrës së rrethit, ku të gjitha fetë qëndrojnë përqark saj dhe në mes të këtij rrethi, çdo njëri prej tyre, e çon një rreze, që nënkupton shërgun e saj të veçantë sesi kjo fe mbërrin në qendër. Muslimani – sipas tyre – nuk është më me fat në mbartjen e së vërtetës sesa hindusi që adhuron lopën, që të dyja fetë shprehin të njëjtën të vërtetë universale. Idetë e shkollës tradicionaliste e gjejnë burimin e tyre te filozofi ezoterik francez “René Guénon”. Guenon u lind në Francë në vitin 1886 e.s., ai u rrit në një ambient fetar katolik dhe më pas u edukua nga njerëzit e rendit jezuit. Në vitin 1909 e.s. ai themeloi revistën ezoterike “La Gnosé” ose ndryshe “Njohja”. Në vitin 1911 e.s. ai përqafon tarikatit shadhili nga dora e ezoterikut, masonit suedez Ivan Aguéli, ose i njohur ndryshe si shejh Abdulhadi Akili -siç e kishte quajtur vetveten- dhe një nga mbrojtësit e flaktë të Ibn Arabiut. Një vit më pas Guenon kryen ritualet masone duke u bërë pjesë e lozhës Thébah që ishte pjesë e lozhës së madhe masone franceze. Në vitin 1924 e.s. ai shkroi librin “Lindja dhe Perëndimi” në të cilën ai fton në shpëtimin e botës perëndimore nëpërmjet ringjalljes ezoterike hinduse.

Në vitin 1930 e.s. Guenon zhvendoset

në Kajro dhe atje martohet me vajzën e njërit prej shehlerëve sufi dhe më pas njihet me emrin “Abdul-Uahid Jahja”. Por edhe pas kësaj ai u jep aprovimin disa miqve të tij të themelojnë në Francë një lozhë masone me emrin e një prej librave të tij “La Grande Triade”, ku flitet për mënyrën sesi kryhen ritualet masone. Guenon vdes në vitin 1951 e.s. duke u shndërruar për disa, një nga personalitetet madhështorë të Islamit!

Një nga nxënësit e tij më të njohur qe ezoteriku i paturp zvicerani “Frithjof Schuon”, cili u fut në tarikatit sufi aljujeh, e themeluar nga shejh “Ahmed Aljuh”, i njohur për mungesën e tij etike ndaj Profetit (alejhi salatu ue selam) dhe broçkullat e tij panteiste (shetahatuhu hululijeh). Pas vdekjes së shejhut të tij, tek Schuon ngjallet damari i tij i krishterë dhe kështu ai themelon tarikatit “Merjemije” që e merr emrin nga Merjemja (alejha selam), pasi – sipas tij- ai e pa atë në ëndërr, në një pamje që për pozitën e saj është turp ta përmendim. Ndjekës të këtij tarikati nuk ka vetëm musliman, por edhe çifut, të krishterë, hindus, ... etj.

Nxënës i këtij zindiku të fundit qe edhe shkrintari anglez “Martin Lings”, autori i librit të njohur “Jeta e Muhamedit (alejhi salatu ue selam) bazuar në burimet e hershme”

Ky merjemist thotë në librin e tij “Ora e Njëmbëdhjetë”: “Mbretëria e qiellit gjendet brenda teje. Kjo e vërtetë është themeli i ezoterizmit, dija dhe studimi i së brendshmes. Angazhimi i mistikut e tejkalon shpëtimin dhe shkon drejt shenjtërimin, që është një nga kuptimet më të larta të hyjnitetit, pra drejt unitetit me përsosmërinë absolute të qenies hyjnore. Fena-ja (tretja në Zotin) në të gjitha rastet është “Nirvana” budiste, në misticizmin islam shprehja se “sufiu është i pa krijuar” dëshmon për të njëjtin realitet absolut.”

Ndërsa diku tjetër ai thotë: “Por e vërteta imponon vetveten e saj, asgjë tjetër veç doktrinës së përkryer “samsara”, nuk mund të paraqes një koncept të tillë për ekzistencën, që i përgjigjet kërkesave të arsyes meditative, duke e konsideruar atë themelin simbolik në meditimin e Hyjit absolut.”

Duket sikur ky njeri nuk e lexuar fjalët e Allahut të Lartësuar që thotë: “Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) **“O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh(nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.”** (Al-Imran: 190-191)

A nuk i mjaftuan këto fjalë këtij njeriu, por shkon e na prezanton idhujtarinë e hindusve dhe të budistëve dhe na i vë ato para shpalljes së Zotit të Botëve?!

Kjo është vetëm maja e ajshbergut të fjalëve që ka thënë ky njeri, ndërkohë që për shumë muslimanë ai konsiderohet si një nga autoritetet e shquara të thirrjes islame në Britani, pa përmendur këtu problemet që ka libri i tij “Jeta e Muhamedit (alejhi salatu ue selam) bazuar në burimet e hershme”, të cilat nuk është vendi këtu për t’i shtjelluar, por qëllimi është vetëm të paralajmëroj për doktrinën që ai trashëgoi nga mësuesi i tij katoliko-ezoterik, Frithjof Schuon, dhe nga të devijuarit e tarikateve sufiste. Kjo idhujtari, të cilën ata e quajnë “e vërteta”, është feja e përrjetshme për

ndjekësit e lëvizjes “tradicionaliste”. Mbërritja te kjo “e vërtetë” arrihet nëpërmjet çdo rruge, qofshin këto meditimet budiste, joga hinduste, apo rituale masone. Kjo shkollë mbart brenda saj pikëpamjet e tretjes në Zotin (hulul) dhe unifikimit me Të (itihad) dhe te mjaft prej ndjekësve të saj edhe rimishërimin e shpirttrave, ndaj nuk është çudi pse Ibn Arabiu është një nga imamët e tyre.

Një nga ndjekësit e njohur të kësaj shkollë është edhe “Rozhe Garodi”, i cili tregoi entuziazmin e tij për librat e Guenonit, në një intervistë me filozofin Alain de Benoist. Përpjekjet e tij për unitetin mes feve dhe futjen e tyre në kallëpin e “Feve Abrahamike” janë mjaft të njohura, sado do zgjateshim nëse do t’i përmendnim. Këtë konstatim e mbështet edhe opinioni i gazetarit investigativ amerikan Robert Dreyfuss, në librin e tij “Peng të Homeinit” (fq. 211-212) ku ai thotë: “Sipas burimeve iraniane S. Husein Nasr e bindi kancelarin e Universitetit të Teheranit Hushang Nahavandi, një këshilltar ky i Shahbanout (gruaja e Shahut të Persisë), të kanalizonte miliona dollarë te francezi me lidhje jezuite, teoricieni Rozhe Garodi, për institutin e tij të Dialogut dhe Qytetërimin... Garodi është një figurë e rëndësishme e operacioneve të shërbimit inteligjent britanik. Ai ka ndikim të madh në post-revolucionin iranian dhe në mesin e ultra majtistëve në Algjeri, dhe gjithashtu një nga mentorët më të afërm të Gadafit në Libi. Garodi është një ish teoricien i Partisë Komuniste i konvertuar në katolicizmin roman nëpërmjet ndikimit të Pere Lebret, një autoritet jezuit ky, në konservimin e strukturës sociale të shoqërisë afrikane bazuar në artin e magjisë fisnore.”

Librat e Garodit edhe pse mjaft të njohur, nuk kanë më atë ndikim që kishin në shek. XX, kështu që një tjetër personazh i rëndësishëm ka dalë në skenë dhe që luan të njëjtin rol, por në një formë disi më të butë. Ky personazh është autorja angleze Karen Armstrong. Armstrong është një nga autoret më të rrezikshme që punojnë për idenë e unifikimit të feve, duke u nisur nga doktrina e “tradicionalizmit” apo ndryshe “fesë së përrjetshme”. Dallimi në mes saj dhe atyre që përmenda është se, ajo nuk e ka pranuar Islamit, siç bën të parët, por ajo merr pjesë nëpër konferenca dhe dokumentarë të ndryshëm sikur të përfaqësonte Islamit, aq sa disa naivë besojnë se ajo është shumë pranë pranimin të fesë islame. Duhet ditur se ajo ka qenë më parë një murgeshë e katolike jezuite, në “Shoqëria e Fëmijës së Shenjtë Jezus” dhe sipas pretendimit të saj ajo e braktisi katolicizmin dhe nuk përqafoi ndonjë fe tjetër.

Idetë e saj “tradicionaliste” duken qartë për atë që lexon librin e saj “The Case for God”. Në të ajo pretendon se njerëzit dikur nuk adhuronin ndonjë zot me cilësi të veçanta, por adhuronin ekzistencën absolute, derisa në skenë dolën fiset ariane në Indi në shek. X para erës sonë, të cilët e quajtën këtë të adhuruar me emrin “Brahman”, ekzistencën absolute. Ndaj pikërisht për këtë ajo u thur lavde sufistëve ekstrem kur thotë: “Dega mistike e Islamit, Sufizmi, insiston se kur ti je në prezencë të Zotit, ti nuk je as çifut, as i krishterë dhe as muslimanë. Ti je në shtëpinë e Tij edhe nëse ti je në një sinagogë, xhami, tempull apo kishë, sepse të gjitha fetë e drejtë-udhëzuara vijnë nga Zoti. Dhe një njeri i Perëndisë,

pasi të hedh një vështrim hyjnor, i lë pas shpine këto dallime qëka shpikur njeriu.” Për sa i përket qëndrimit të saj që ajo mban ndaj Islamit, nuk dallon shumë nga orientalistët e tjerë, ajo në librin e saj “Historia e Zotit”, që në arabisht është përkthyer me titullin “Allahu dhe njeriu”, pasi flet për përmendjen që Kurani i bën Profetëve Israelitë, thotë: “Muslimanët sot këmbëngulin se nëse Muhamedi do t’i kishte njohur hindustët dhe budistët do t’i kishte shtuar edhe historitë e liderëve të tyre.” Pra, nuk mjaftohet vetëm me pretendimin se Kurani është produkt i shkruar nga vetë Profeti (alejhi salatu ue selam), por i konsideron mistikët jomuslimanë, liderët e hindustëve dhe budistëve si Profetë dhe të Dërguar të Zotit!

Në një vend tjetër ajo thotë: “Nga judenjtë miqësorë të Medinës, Muhamedi mësoi gjithashtu historinë e Ismailit, djalit të madh të Abrahamit.” Nuk e di se nga kush duhet të habitem më shumë: nga judenjtë miqësorë apo nga mësimi që ata i dhanë zotnisë së njerëzimit (alejhi salatu ue selam)?

Kjo autore ka marrë një iniciativë ndërkombëtare, të cilën e ka quajtur “Karta e Dhembshurisë” (Charter for Compassion) të cilën e nis me fjalët: “Parimi idhembshurisë qëndron në zemër të të gjitha traditave fetare, etike dhe shpirtërore.”

Armstrong përpiqet të unifikoj fetë, nëpërmjet qasjes që quhet “e përbashkëta humane”, e cila nuk është asgjë më shumë sesa një urë për propaganduesit e doktrinës “filozofia e përrjetshme”.

Ngjashëm me këtë është edhe përkthimi që ata i bëjnë fjalës “Kelimetin seu” (një fjalë e njëjtë) që përmendet në suren Al-Imran: 64 me fjalën “Common Eord” (një fjalë e përbashkët), ndërkohë që qëllimi i kuptimit të kësaj fjalë në këtë ajet është “fjala e drejtë” që do thotë distancim nga shirkun.

Kohët e fundit kam parë një palo libër, të një autori ka shtuquajtur arab, cili pretendonte në të se “Brahma”, Zoti i hindusve, në realitet është “Ibrahimi” (alejhi selam)! Madje shkrimet hinduse “Veda”, janë fletushkat e Ibrahimit (alejhi selam), duke dashur me këtë të justifikojë termin e pavlerë “Fetë Abrahamike”. Natyrisht që këtë ai nuk e ka nxjerrë nga vetja e tij, por e ka marrë nga disa autorë perëndimorë, por me vetëdije ose jo, ai nuk qëndron shumë larg shkollës së “Rene Guenonit”, i cili shihte te Hinduizmi burimin e fesë së përrjetshme, ku sipas pretendimit të tij është origjina e feve.

Së fundi, dua të them se me këtë përmbledhje të shkurtër dëshiroj t’i informoj thirrësit islam, nxënës të dijes dhe mendimtarë, rreth disa doktrinave ezoterike (batinije), të cilat përhapen me emra të ndryshëm, si dhe t’i njoh me disa personazhe të cilat sot ngrihen lart, ndërkohë që nuk e meritojnë këtë gjë. Kjo temë është mjaft e rëndësishme dhe njerëzit e dijes duhet ta cekin dhe trajtojnë atë e të sqarojnë të pavërtetat e saj, duke mbrojtur kështu anën e teuhidit dhe demaskuar ata që i kundërvihen Allahut dhe të Dërguarit të Tij (alejhi salatu ue selam).

Revista “El-bejan” nr. 301, Ramazan 1433 h./ Gusht 2012 e.s.

<http://www.albayan.co.uk/MGZarticle.aspx?ID=2149>


ISLAMOFOBIA

Nga Justinian TOPULLI

Duket se ky term është tepër i gjerë, ashtu siç ndodh shpesh me terma të cilët zgjerohen nga rrahjet farkëtuese të çekanëve përdorues, që godasin nga të gjitha anët. Si i tillë elementet që përfshihen në të nga grupe dhe këndvështrime të ndryshme e bëjnë shpesh atë një term të debatueshëm ndërmjet palëve përdoruese.

Gjithsesi, i parë me syrin e një muslimani dhe nën një këndvështrim islam, islamofobinë do ta përkufizoja si një sjellje negative karshi Islamit dhe muslimanëve, që buron nga ndjesia e urrejtjes, neverisë apo alergjisë ndaj Islamit ose muslimanëve për shkaqe nga më të ndryshmet. Sipas këtij përkufizimi islamofobia është një fenomen i vjetër sa vetë Islami, shfaqje të tij të hershme Allahu na i ka përjetësuar në Librin e Tij në ajete të tilla si: **“Urrejtja shfaqet në gjithçka që del prej gojës së tyre, kurse ajo që fshehin në zemrën e tyre është edhe më e madhe.”** (3:118) dhe **“Ata vazhdimisht do të luftojnë kundër jush, që të mund t’ju kthejnë nga besimi juaj.”** (2:217)

Duket se qarqe të caktuara në Perëndim e në botë nuk mundet dot të jetojnë pa peshkuar dhe pa provokuar njëkohësisht armiq nga kultura të ndryshme nga ajo e tyre dhe duke i stigmatizuar ato si burimi i së keqes. Kjo nuk është diçka e re në historinë e Perëndimit, fobiandajmbulesësë femrës muslimane, referendumi kundra minareve të xhamive dhe ksenofobia ndaj prezencës në rritje të vetë muslimanëve në këtë pjesë të botës duket se në një farë mase të kujton rritjen e urrejtjes antisemite në Evropën e viteve 30'. Ashtu si atëherë qarqe fashiste edhe sot qarqe të djathta ekstremiste dhe konservatore duket se tentojnë që për arsye pragmatiste dhe politike ta shndërrojnë Islamit dhe muslimanët në kupën e zemërimit ku ata do të derdhin arsyet e krizave të tyre, që kjo botë po përjeton. Kjo tendencë duket se ka pasur rritje në veçanti pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, që për ta paska qenë pikërisht precedenti i munguar për të penalizuar një fe dhe kulturë të tërë. Në fakt duket se historikisht njerëz dhe kultura që tentojnë të jenë monolite, egocentrike dhe nuk pranojnë kontributin e të tjerëve prirën që



forcën e jetës dhe të zhvillimit ta gjejnë pikërisht tek armiqësia ndaj tjetrit dhe të projektojnë tek ai qoftë edhe një pjesë të fatkeqësive të tyre. Në mjaft raste duket se një mekanizëm i tillë ka funksionuar mjaft mirë.

Përkundrajt kësaj islamofobie të niveleve të larta, që përjeton sot perëndimi duket se edhe muslimanët shpesh reagojnë keq, së pari duke stigmatizuar të gjithë Perëndimin si islamofob dhe për rrjedhojë duke projektuar qoftë edhe një pjesë të fatkeqësive të tyre tek këta rivalë shëkullorë. Natyrisht që kjo bie ndesh me mësimet islame, të cilat thonë se: **“Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj një pjese të njerëzve për të qenë të padrejtë. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë.”**

Dhe **“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.”** Ndërsa parimet islame për asnjë moment nuk bëjnë fajtor për fatkeqësitë të tjerët, qofshin këta edhe armiq të më të ashpër: **“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet është si pasojë e asaj që keni bërë vetë.”** (30:42).

Dhe së dyti, tek një pjesë tjetër e muslimanëve islamofobia duket se ka prodhuar ndjenjën e të qenit inferior si dhe vetëpenalizimin e kulturës dhe fesë që ata mbartin, kjo për rrjedhojë është duke çuar drejt zhveshjes identitare islame të këtyre muslimanëve dhe drejt asimilimit në kulturat ofensive.

Duke e mbyllur do të shpreheshja se islamofobia nuk është gjë tjetër vetëm se “një verë e vjetër në fuçi të re”, e cila duket se ka dehur keq shumë prej atyre që nuk jetojnë dot pa e pirë atë, ashtu siç edhe aroma e saj duket se ka trullësuar ca më keq akoma ata të cilët e kanë të ndaluar ta pinë atë. Le ta lusim Zotin që të mos shtohen të dehurit andej dhe kënde!

* Botuar më parë në revistën **ALBISLAM**

ERDOAN I PROPOZON OKB-SË QË ISLAMOFOBIA TË VLERËSOHET SI KRIM

Kryeministri i Turqisë, Rexhep Tajip Erdoan, çështjen e filmit “Pafajësia e Myslimanëve”, i cili shkaktoi protesta masive në botën islame, po përgatitet ta ngrejë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në takimin, që Asambleja e Përgjithshme e OKB-së do të mbajë javën e ardhshme, Erdoan do të sjellë në rend të ditës propozimin: “Islamofobia të vlerësohet si krim”.

Shefi i qeverisë së Ankarasë, i cili iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve gjatë kthimit të tij nga vizita në Bosnjë-Hercegovinë, filmin në fjalë, që përmban fyerje të rënda ndaj islamit dhe Profetit Muhamed, e cilësoi si një provokim publik dhe një qasje armiqësore.

Kurse në përgjigje të një pyetjeje lidhur me marrëdhëniet Turqi-Izrael, përpjekjet në rritje të Tel-Avivit zyrtar gjatë kohëve të fundit për të ndrequr relacionet me Ankaranë, Kryeministri Erdoan i komentoi me fjalët: “Janë zhytur në vetmi (izraelitët). Aktualisht janë vënë seriozisht me shpatulla pas murit.”

Provokimi me anë të filmit “Pafajësia e Myslimanëve” ishte edhe në agjendën e zv/kryeministrit turk, Bekir Bozdaë. Ai vuri theksin mbi rëndësinë e bashkëveprimt të komunitetit ndërkombëtar për parandalimin e racizmit dhe diskriminimit.

“Sulmi ndaj konsullatës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Libi është gabim i jashtëzakonshëm. Islami e ndalon dhunën dhe vrasjen e njerëzve. Reagimi i një grupi njerëzish përtej masave dhe me mënyra të papranueshme nga islami ishte një gabim trashanik. Duam ta nënvizojmë edhe këtë fakt. Si Turqi, ne vazhdojmë ta shprehim ndjeshmërinë tonë mbi këto çështje në çdo vend të botës, gjë që do të vijojmë ta bëjmë edhe në të ardhmen. Është e nevojshme,

si kurrë më parë, që shoqëria ndërkombëtare të bashkëveprojë për parandalimin e islamofobisë, racizmit, diskriminimit dhe çdo lloji tjetër të ekstremizmit në Evropë dhe vende të tjera. Me dobi do të jetë që islamofobia dhe disa fundamentalizma të tjera të përkufizohen si krim brenda rendit ligjor”, tha zv/kryeministri turk, Bekir Bozdaë gjatë një interviste për TRT-në.

Fillojnë të zbardhen detajet në lidhje me autorin e filmit anti-islamit të regjistruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ka ngritur në këmbë tërë botën myslimane. Personi që mendohet se është autori i filmit që shkaktoi demonstrata në botën myslimane, mor nga shtëpia e tij, ndërkohë që kishte mbuluar fytyrën dhe u dërgua në polici. Bëhet e ditur se producenti Sam Bacile është një i krishterë egjiptian i quajtur Nakoula Basseley Nakoula. Ai u largua me vullnetin e tij nga shtëpia, ku u mor në pyetje nga autoritetet federale dhe nuk është i arrestuar. Nakoula, më parë është dënuar për mashtrime bankare në vitin 2010 dhe ku ishte dënuar me burgim shtëpi dhe po merret në pyetje për mundësinë e shkeljes së rregullave të lirit të tij me kusht. Ai kishte deklaruar se kishte publikuar në You Tube pjesë nga filmi “Pafajësia e Myslimanëve”. Kurse regjisorin e filmit pretendohet se është Alan Roberts, i cili fshihet që kur kanë filluar ngjarjet në lidhje me filmin. Nga ana tjetër, kompania e Google ka refuzuar kërkesën e Shtëpisë së Bardhë për të hequr filmin nga You Tube. Ndërkohë që India dhe Indonezia e kanë censuruar videon, Egjipti dhe Libia ka penguar aksesin në të. Edhe qeveria e Malajzisë, ka kërkuar nga Google që ka refuzuar kërkesën për heqjen e filmit, që të pengojë aksesin në këtë film. Kurse Afganistani ka ndaluar tërësisht hyrjen në You Tube.

Sabra dhe Shatila 30 vite më parë

Ndërmjet 15 dhe 18 shtatorit 1982 ministri izraelit i mbrojtjes Ariel Sharon dhe një nga gjeneralët e tij Rafael Eitan dërguan milicinë e Falangave të Krishtera Libaneze brenda kampit të refugjatëve palestinezë të Sabras dhe Shatilas me urdhrat për t'i zhdukur krejt refugjatët palestinezë. Ndërsa falangistat po kryenin mizori dhe masakra të papara ndonjë herë forcat izraelite e vulosën kampin, duke i ndaluar palestinezët të largoheshin dhe ndonjë të jashtëm të hynte brenda. Ndërsa më shumë se 2,750 pleq, gra e fëmijë vriteshin Kneseti izraelit vepronte sikur nuk kishte ndodhur ndonjë gabim.

Ariel Sharoni është përgjegjësi kryesor si

kriminel lufte për masakrat e ndodhura në kampin e refugjatëve të Sabras e Shatilas në Liban. Një trupë hetimore e vetë Izraelit, Komisioni Kahan e ka gjetur Sharonin përgjegjës për këto masakra dhe më tej ka rekomanduar, që Sharoni të largohet funksionet publike. Disa mijëra izraelitë dolën nëpër rrugë më 1982 për të protestuar ndaj këtyre veprimeve të Sharonit dhe për disa mijëra vota ato e zgjodhën sërish kryeministër më 2001. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ka shpallur se janë vrarë 2,750 njerëz në Sabra dhe Shatila; figura reale e kësaj masakre mendohet të jetë akoma edhe më lart dhe mund të mos e dijë kurrë.

Simpozium/

ISLAMI FE E MESATARISË



Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
organizon simpoziumin me temë:

ISLAMI, FE E MESATARISË

*"Dhe kështu ju bëmë juve një bashkësi
të mesme për të qenë dëshmitarë të njerezve
dhe që Pejgamberi të jetë dëshmitar i juaji."
(Bekare, 143)*

Që nga mbarimi i Luftërave Botërore ka pasur zhvillime të fuqishme politike dhe ndryshime dramatike "të rendit botëror", të cilat kanë përfshirë Ballkanin dhe Shqipërinë njëkohësisht. Rënia e bllokut social-komunist dhe ndryshimi i hartës ballkanike na kanë vendosur para një realiteti të ri globalizues. Pas shtatorit 2001 bota nuk do të ishte më ajo që kishte qenë dhe popujve iu desh të ripozicionoheshin gjeo-politikisht, po ashtu edhe neve. Zhvillimet teknologjike me joshjen e tyre të prodhimeve të fundit, sidomos të smart-phone dhe kompiuterave tableta i kanë dhënë një nxitje të paparë komunikimit masiv, duke i vënë njerëzit para alternativave të reja për të arritur t'i pronësojnë këto vegla, si dhe shërbimet që mund të vihen në dispozicion nëpërmjet tyre. Ndërkaq muslimanëve iu duhet të ecin nëpër shtigje të ndryshme dhe vende të ndryshme për të gjetur veten në këtë realitet të krijuar së fundmi në Shqipëri dhe nëpër trojet tona etnike. Ndërkaq nga ana tjetër kemi Islamit dhe xhematin, të cilëve iu duhet të ballafaqohen në përditshmërinë e tyre me lloj-lloj problemesh, ku këto lloj veglash e shërbimesh janë bërë tashmë domosdoshmëri. Gjithashtu në këtë dekadën e fundit Islami si fe dhe muslimanët janë gjendur para një presioni të madh mediatic, duke u paraqitur gjithmonë në ekstrem. Para këtij presioni tashmë të një islamofobie në rritje vërehet së fundmi nga disa gazeta në Kosovë, ku para një presioni të tillë muslimanët shqiptarë u gjendën në dekadën e kaluar. Termin mesatari në veprime për herë të parë e kam hasur në veprat e hoxhës së mirënjohur tiranas H. I. Dalliu. Po ashtu edhe ajeti i Kuranit i përzgjedhur si moto e këtij takimi e shpreh qartë këtë qëndrim të

hoxhallarëve tonë të brezit të parë, si dhe kjo tregon se edhe hoxhallarët e rinj të këtij brezi i kanë vënë theksin e domosdoshmërisë kësaj teme. Në panelin e kësaj tribune të organizuar nga Lidhja e Hoxhallarëve ishin tre emra të mirënjohur në mjediset myslimane, dy hoxhallarë të shquar Bekir Halimi dhe Justinian Topulli si dhe gazetari dhe analisti Fitim Zekthi. Në trajtesën e tij "Islami si një fe e mesme" hoxha Justinian Topulli e shqyrtoi temën e tribunes nga ana teorike duke i bërë një zbrëthim dhe përshkrim analitik bazuar në konceptin e të mesmes në Islam të përmendur në Kuran, si dhe mendimet dhe ç'kanë thënë rreth kësaj teme dijetarë të mëdhenj të Islamit. Më pas tribuna vijoi me kumtesën e analistit Fitim Zekthi "Një optikë mbi portretizimin e Islamit në Media", ku shpalosi nëpërmjet fakteve shumë të pasura presionin e ngritur mbi bashkësitë myslimane dhe Islamit. Gjithashtu ai i kushtoi vëmendje të posaçme edhe rrymave bashkëkohore liberale dhe konservatore nga të cilat udhëhiqen edhe parimet mediaticke të të bërit të lajmeve. I fundit kumtoi hoxha i mirënjohur Bekir Halimi nga Shkupi, që në mënyrë të përmbledhur dhe kuptimplote përcolli te të pranishmit disa mendime dhe lëvizje ekstreme të paraqitura së fundmi në trojet tona, si dhe qëndrimin e mesëm që duhet mbajtur sipas Islamit. "Praktikimi i Islamit mesatar në jetën e përditshme" ishte tema e hoxhë Bekir Halimit, me të cilën u plotësua kuadri i kësaj veprimtarie të rëndësishme. Gjithashtu vërejmë se e veçanta e kësaj veprimtarie ishte tema e saj, e cila përpunohet për herë të parë nga hoxhallarët për publikun e gjerë mysliman.

"PRAKTIKIMI I ISLAMIT MESATAR NË JETËN E PËRDITSHME"/Realiteti Shqiptar



Hoxhë Bekir HALIMI

(Nga afetarët, ateistët e të tjerët
edhe një musliman edhe jo aq fetar
shpeshherë llogaritet ekstremist,

*prandaj ne nuk flasim nga këndi i
tyre, por kjo që do të them vjen nga
këndi i një hoxhe dhe analizës që i bën
realitetit tonë shqiptar).*

Duke analizuar realitetin tonë shqiptar dhe komunikimi i gjatë me hoxhallarët dhe xhematin shqiptarë vë vendet e ndryshme tona, kam ardhur në këto përfundime dhe konstatime. Pa dyshim se këto janë analiza të mia personale, të cilat mund edhe të kontestohen nga të tjerët, por është rezultat i një veprimi meqanor i dy dekadave kohë dhe besoj se kjo kohë ka qenë e mjaftueshme për të analizuar këto fenomene, sidomos kur e kemi parasysh faktin se në shumë raste të kështilla jemi pyetur dhe është dashur të sqarohet qëndrimin tonë në lidhje me këto tema. Andaj në vijim do të

përmendi fenomenet e ndryshme me të cilat jemi ballafaquar dhe ndarja e muslimanëve në dy anë dhe mbetet të sqarohet mesazhi, sipas studimeve dhe analizave tona.

- Imani përbëhet prej: bindjes, shprehjes dhe veprave. Përballë kësaj kemi:

Ata që çdo vepër e bëjnë pjesë të besimit dhe Ata që veprat aspak nuk i fusin në tërësinë e besimit

Suneti është çdo fjalë, vepër, përshkrim moral ose fizik. Përballë kësaj kemi: Ata që me çdo kusht dëshirojnë edhe sunetet adete t'i praktikojnë, si dhe ata që nuk e përfillin sunetin aspak.

Bidati është çdo gjë e shtuar në fe me të cilën njerëzit synojnë t'i afrohen Allahut, qoftë kjo shtesë në origjinë apo si modifikim i një adhurimi. Përballë kësaj kemi: Ata që çdo shtesë e llogarisin bidat dhe luftojnë ekstremisht kundër atyre, që në bazë të interesit fetar bëjnë shkallëzimin e largimit të tyre, me ata që nuk brengosen aspak për bidatet dhe i aprovojnë si të tilla dhe nuk i kundërshtojnë.

- Politika në rrethanat tona fetare është veprimi me të cilin krijohen kushte për një jetë fetare më të mirë. Përballë kësaj kemi: • Ata që e kundërshtojnë në bazë të parimit, se çdo gjë që nuk ka bazë në fe është kufër dhe ajo duhet mohuar dhe kundërshtuar, me ata që nuk i përfillin aspak rregullat fetare, kur merren me këtë fenomen, por shndërrohen në makiavelistë në rrugën e arritjes së qëllimeve të tyre.

- Xhihadi që sipas parimeve të fesë domethënë lufta kundër së keqes dhe atyre që e pengojnë të mirën me fjalë, pasuri dhe shpirt. Përballë kemi: • Ata që çdo luftë, përfshirë edhe atë që bëhet kundër muslimanëve ta llogarisin xhihad, me ata që aspak nuk e përfillin këtë adhurim të madh, madje në mënyrë direkte ose indirekte e mohojnë si detyrë dhe obligim.

- Burimet e fesë, të cilat janë themelore Kurani dhe Syneti dhe plotësuese Konsensusi dhe analogjia (kijasi). Përballë kemi: • Ata që si burim themelor të fesë paraqesin edhe shijen dhe ëndrrat, me ata që këto burime nuk i përfillin, nëse nuk përputhen me logjikën e tyre.

- Logjika si begati me të cilën Allahu e ka nderuar njeriun. Përballë kësaj dhuntie kemi: • Ata që e shenjtërojnë logjikën dhe i japin përparësi më shumë se tekstit të saktë fetar dhe e bëjnë kusht të kuptimit të teksteve fetare, me ata që e refuzojnë tërësisht dhe nuk e përfillin rezultatin e studimit logjik dhe përfundimet e tij.

- Zbatimi i fesë që nënkupton parimi i zbatimit të fesë si tërësi e plotë në të gjitha fushat dhe segmentet, jetën private, publike, shoqërore, intelektuale, humanitare, politike, arsimuese, ideologjike etj. Përballë kemi: • Ata që mundohen edhe detajet më të vogla të fesë t'i praktikojnë në një rreth, i cili në shumicë dërrmuese është afetarë, me ata që praktikojnë nga feja vetëm atë që u pëlqen dhe u përshtatet me rrethanat e tyre personale dhe shoqërore.

- Hoxhallarë dhe intelektualë, të cilët duhet të jenë në shërbim të fesë dhe të ndihmojnë njëri tjetrin duke plotësuar boshllëkun e njëri-tjetrit. Përballë këtij fenomeni kemi: • Hoxhallarët injorojnë intelektualët për shkak të disa qëndrimeve liberale ndaj shoqërisë dhe qëndrimeve të vrazhda ndaj hoxhallarëve dhe Intelektualët injorojnë hoxhallarët për shkak të mungesës së kulturës së gjerë të tyre, ose mungesës së qëndrimeve të caktuara përballë fenomeneve të caktuara që paraqiten në shoqëri.

- Muslimanët dhe komunitetet myslimane. Përballë këtij fenomeni kemi: • Ata që i nënshtrohen tërësisht dhe i përligjin edhe gabimet dhe veprimet e gabuara fetarisht,

politikisht dhe administrativisht, me ata që çdo gjë që bëjnë ata, e kundërshtojnë dhe e refuzojnë edhe nëse është e mirë dhe e dobishme.

- Muslimanët dhe sektet e ndryshme. Përballë kemi: • Ata që gjithë energjinë e tyre e harxhojnë në demaskimin dhe tregimin e fytyrës së vërtetë të këtyre sekteve dhe ata që i injorojnë tërësisht dhe nuk merren aspak me ta, madje disa herë edhe i arsyetojnë.

- Muslimanët dhe media. Përballë kemi: • Ata që i injorojnë mediat e ndryshme tërësisht dhe nuk dalin me qëndrimet, pikëpamjet dhe opinionet e tyre, si dhe ata që i shfrytëzojnë mediat, por kur paraqiten aty paraqesin aq qëndrime të buta dhe liberale, saqë e dëmtojnë zhvillimin e davetit Islam.

- Muslimanët dhe problemet shoqërore. Përballë kemi: • Ata që zhyten në këto probleme dhe pastaj me lodhjen dhe angazhimin e tepërt edhe ata shndërrohen në problem shoqëror, me ata që i injorojnë dhe nuk merren aspak me to, ndoshta edhe i kundërshtojnë këto aktivitete si veprime.

- Fikhu Islam. Përballë kemi: • Ata që insistojnë në ndjekjen strikte të medhebeve tradicionale dhe qortimin e atyre që dalin nga këto korniza, me ata që i kundërshtojnë tërësisht medhhebet, i injorojnë ato dhe sillen keq me ndjekësit e medhhebeve.

- Liderët tanë. Përballë tyre kemi: • Ata që i glorifikojnë deri në skajshmëri dhe e llogarisin gabim, madje edhe gjynah çdo kundërshtim të tyre, si dhe ata që nuk pranojnë asnjë autoritet dhe rebelohen karshi secilit lider që ne krijojmë.

- Islamofobia, frika e paarsyeshme nga Islami. Përballë kemi: Ata që merren vazhdimisht me këtë fenomen dhe i lënë pas dore obligimet tjera, me ata që nuk e përfillin këtë fenomen dhe nuk janë të përgatitur për t'i dhënë përgjigje dilemave që iu paraqiten.

*Teme e mbajtur ne simpoziumin e organizuar nga LSH, "Islami fe e mesatarise"

Dijetari MUSLIMAN ABDUL MEXHID Zendani ka arritur të zbulojë ilaçin kundër HIV-it!

Ky lajm është bërë i ditur pak kohë më parë, por tashmë Shejh Zedanit i është dorëzuar zyrtarisht çertifikata WIPO. Ilaçin e tij ai e ka regjistruar pranë OKB-së. Për këtë zbulim epokal ky dijetar i mirënjohur musliman u çertifikua nga institucioni më i njohur ndërkombëtar për çertifikimet intelektuale, një institucion që është i lidhur me Kombet e Bashkuara-WIPO. Shejh Zendani shprehet se këtë ilaç e ka bërë sipas mjekësisë profetike! Kështu shpresojmë që muslimanet t'i kthehen fesë së tyre më fuqishëm, e në këtë mënyrë t'i sjellin dobi në radhë të parë vetes së tyre dhe më pas të tjerëve. Një prej problemeve më të mëdha të shoqërisë moderne janë sëmundjet e shumta të brendshme seksualisht të transmetueshme, që e kanë përfshirë njerëzimin, dhe sot e kësaj dite ka disa prej tyre që nuk kanë shërim. Njëra prej këtyre sëmundjeve të pashërueshme ka qenë edhe AIDS-i (apo SIDA), deri sa dijetari jemenas Abdulmexhid Zendani e zbuloi ilaçin e kësaj sëmundjeje moderne të kohës së amoralitetit.

MUHAMEDI A.S. NJERIU I SHUMË DHUNTIVE

Prof. Shah HAMID*

Profeti Muhamed (paqja e Zotit qoftë mbi të) ishte vazhdimisht një njeri i qeshur, gjenial, i këndshëm dhe i dashur. Atë nuk e shihje kurrë të ashpër apo të vrazhdët në komunikimin me njerëzit. Ai fliste gjëra që i sillnin shpërblimin e Zotit të Plotfuqishëm. Kur fliste ai të pranishmit e dëgjonin me vëmendje. Ata nuk tërhiqeshin nga ndjesia për të hyrë në debate të zjarra me të. Profeti do të tregonte gjithmonë durim ndaj ashpërsisë së sjelljeve dhe të folurit të vrazhdë të ndonjë të huaji. Ai zakonisht thoshte: "Kur ju të shihni ndonjë person që kërkon diçka me këmbëngulje, ndihmoheni atë që të plotësojë nevojën e tij." (Tirmidhi). Dhe nuk është për t'u habitur kur Allahu i Lartësuar thotë për Profetin:

"Vërtet, ti je në një shkallë të lartë morali!" Kalem 68: 4.

Fytyra e një personi jo vetëm pasqyron ndjenjat e zemrës së tij, por gjithashtu na sinjalizon për qëndrimin e tij, ose të saj për botën që e rrethon atë. Me të vërtetë që ne mund të themi, se i gjithë personaliteti i një njeriu pasqyrohet në fytyrën e tij. Të flasësh për Profetin Muhamed dhe fytyrën e tij të qeshur si një burim ngushëllimi dhe qetësimi për të gjithë ata që shkonin për ta vizituar atë dhe jo vetëm fjalët dhe veprat e tij, por ishte vetë shprehja e fytyrës së tij që përhapte rrezet e paqes dhe të qetësisë në zemrat e atyre, që ishin të shqetësuar nga sprovat e jetës, apo të torturuar nga pikëllimet e shpirtit. Një nga shokët e Profetit Muhamed, Abdullah ibn Harithi na rrëfen, se: "Unë nuk kam parë ndonjë njeri më të buzëqeshur, se sa të Dërguarin e Allahut." Buzëqeshja e Profetit përhapte një atmosferë të papërshkrueshme gëzimi ndërmjet Shokëve të tij, aq sa i bënte ata të harronin ankthet dhe vështirësitë e tyre, kur ishin së bashku me të dhe të magjepseshin pas tij. Arsyja e vërtetë është se Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të) kishte një personalitet të përkryer, të dhuntisur e të pajisur me joshje të pastër njerëzore dhe gjenialitet. Mënyrat e sjelljes së tij ishin plot me harmoni dhe

mëshirë. Ai ishte shumë i sjellshëm dhe i vëmendshëm ndaj të gjithëve dhe në fytyrë i shihej një buzëqeshje e përhershme. Një herë ai i tha shokëve të tij: "T'i buzëqeshësh vëllait tënd është bamirësi". (Tirmidhi).

Kemi një rast shumë interesant që na rrëfhet



nga Sad ibn Ebi Vekasi:

"Njëri nga shokët e Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të), Omer ibn Hatabi kërkoj leje ta takonte atë. Në të njëjtën kohë tek ai gjendeshin disa gra kurejshite, që ishin ulur me të, duke i kërkuar atij që t'iu jepte mbështetje financiare dhe ato po i ngrinin zërat e tyre mbi zërin e Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të). Kur Omeri kërkoj leje për të hyrë të gjitha ato shpejtuan të fshiheshin pas një perdeje. Profeti e pranoi Omerin dhe ai hyri duke hasur në buzëqeshjen e tij. Omeri i tha:

"Allahu të bëftë përherë të buzëqeshur, o i Dërguari i Allahut! T'u bëfshin kurban nëna dhe babai im!" (Kjo shprehje përdorej asokohe për t'i treguar afërsinë dhe dashurinë dikujt tjetër.)- Profeti tha:

"Po habitem me këto gra që ishin me mua. Sapo dëgjuan zërin tënd, ato nxituan të fshihen pas perdes." - Omeri i tha:

"Ti ke më tepër të drejtë, që ato të të frikësohen ty, o i Dërguari i Allahut!"- Omeri u kthye atyre dhe iu tha: "O armiqtë e vetëve tuaja! Ju më keni frikë mua dhe jo të Dërguarin e Allahut?"- gratë iu përgjigjën:

"Po, sepse ti je më i ashpër dhe i sertë, se sa i Dërguari i Allahut."- I Dërguari i Allahut tha: "O i biri i Hatabit! Pasha Atë që në duart e Tij është shpirti im, ngado që Shejtani të të shohë se ku do të shkosh, ai ndjek një rrugë tjetër nga e jotja!" (Buhari).

Një shok tjetër i Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të) Xherir ibn Abdullah thotë: "Që nga koha kur e pranova Islamin Profeti nuk ka kaluar asnjë herë pa më vërejtur. Kudo që më shihte ai do të më buzëqeshte mua." (Buhari). Të gjithë ata që e patën njohur Profetin (paqja e Zotit qoftë mbi të) magjepseshin dhe tërhiqeshin nga dinjiteti dhe madhështia e karakterit të tij. Shprehjet e tij të ëmbla dhe miqësore krijonin një përshtypje të thellë tek çdo i huaj që e takonte atë. Asnjë person tjetër në histori nuk është privilegjuar duke pasur kaq shumë cilësi të jashtëzakonshme dhe natyrisht që Shokët e tij (sahabet) ishin të gatshëm të sakrifikonin jetën e tyre për ta mbrojtur atë. Bujaria dhe mikpritja e tij ishin të pakrahueshme; dhe ai ishte njeriu i fundit që mund të mërziejte apo të zemërohej. Me të vërtetë që ai ishte aq shumë bujar, sa që ai nuk do t'i mohonte kurrë atë që atij i kërkohej. Falja dhe amnistia e përgjithshme e bërë nga Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të) për Kurejshitet e Mekës, që e kishin fyer dhe persekutuar atë për më tepër se dy dekada është e mirënjohur tashmë. Një historian perëndimor Uilliam Mjuir shkruan: "Zemërgjerësia me të cilën Muhamedi e trajtoi një popull, që e kishte urreyer për një kohë të gjatë dhe e kishte përgjatur atë është e meritueshme për çdo lloj admirimi." Deri edhe armiqtë e Profetit ia kanë njohur ndershmërinë dhe drejtësinë e tij. Shumë më përpara se atij t'i jepej profecia, ai thirrej Emin (arab. besnik, i besueshëm) dhe për këtë popull i drejtohej atij për gjykime dhe këshilla.

Ai nuk i lejonte njerëzit t'i qëndronin në shenjë respekti në këmbë, ashtu si mund të vepronin zakonisht ata përpara mbretërve apo sundimtarëve. Ai i vizitonte të varfrit dhe fukarenjtë dhe të rrinte me ta ishte një zakon i vazhdueshëm i tij. Ai pa pasur asnjë pikë hezitimi pranonte ftesën qoftë edhe të një skllavi. Thjeshtësia, sinqeriteti dhe gjenialiteti ishin pikat kyçe të karakterit të tij. Gruaja e Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të) Aishja na tregon, se ai i rregullonte vetë këpucët që mbathte, i qepte rrobat dhe merrte pjesë në punët e shtëpisë. Ai ishte më i mëshirshmi, me

i buti dhe më miqësori me të gjithë njerëzit. Ai mezi priste t'i shërbente kujtdo që i kishte shërbyer atij më parë. Ai e kishte vazhdimisht nën kontroll temperamentin e vet dhe nuk zemërohej kollaj, vetëm po të ishte krejtësisht e nevojshme. Nëse ai me të vërtetë do të zemërohej kjo do të ndodhte vetëm për hir të Allahut dhe fesë së Tij, dhe jo për hatrin e vet. Zemërgjerësia e Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të) futi ndërmjet popullit maturinë dhe toleranca i përfshiu të gjithë njerëzit dhe ai u bë si një baba për të tërë ata. Ai ishte i kujdesshëm që të mbante një status barazie me të tjerët dhe nuk dëshironte privilegje. Në një mexhlis ai do të ulej në një pozicion të palakmueshëm nga njerëzit, pas personit të fundit. Kurdo që njerëzit shkonin për ta takuar atë ai i priste ata me nderime dhe respekt, sa që çdo person, i cili kishte qenë me të do të mendonte, se nuk ka ndonjë tjetër që të ishte i nderuar nga vetë Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të), se sa ai apo ajo. Asnjë njeri që e kishte pyetur nuk është zhgënjyer, kur i pati kërkuar këshilla Muhamedit (paqja e Zotit qoftë mbi të). Ai që favorizohej më tepër nga Profeti Muhamed ishte personi i më i devotshëm ndërmjet njerëzve. Sa për ata persona që kishin pozitë të lartë ndërmjet njerëzve të tyre, Profeti ishte i kujdesshëm t'i nderonte dhe t'i respektonte ata. Ai nuk i injoroi kurrë shokët e tij. Për më tepër ai e kishte zakon t'i vizitonte ata qoftë edhe në ditët kur ai ishte shumë i zënë dhe i pyeste ata për gjendjen e tyre. Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të) adaptonte gjithnjë një qasje të moderuar për të gjitha çështjet që i paraqiteshin. Ai zgjidhte gjithmonë rrugën më të lehtë dhe më të kënaqshme për të zgjidhur problemet. Kur ishte në shtratin e agonisë i mori të gjithë paratë e mbetura në shtëpi dhe ua shpërndau të varfërve. Përpara se të jepte frymën e tij të fundit ai e kishte bërë publike, që nëse dikujt i kishte borxh diçka ai mund ta merrte që në atë çast. Këto ishin dhuntitë e Muhamedit, profetit të fundit, i Dërguari i Allahut në tokë për të gjithë njerëzimin. Pretendimi i tij i vetëm për të gjithë njerëzit ishte ta njihnin si i Dërguari i Zotit dhe ta thërrisnin me këtë titull.

* Prof. Shah Hamidi është këshilltar dhe analist i uebsajtit Reading Islam. Ai gjithashtu mban edhe pozicionin e presidentit të Misionit Islamik të Keralas (Kerala Islamic Mission) në Kalkua të Indisë. Ai është autor i tri librave mbi Islamin në gjubën malaje. Librat e tij janë mbi krasisimin e feve, gjendjen e gruas dhe mbi vlerat njerëzore dhe të shkencës.

KUVEYT-TURK DO TË HAPI BANKËN E PARË ISLAME NË GJERMANI

Instituti financiar me bazë në Stamboll – Fondi Investimeve Kuveyt Turk planifikon të hapë bankën e parë islame të këtij lloji në tetor në Gjermani me shpresën e tejkallimit të efekteve të këqija të krizës në vazhdim të euros dhe të marri një copë nga torta e suksesshme e bankimit islam. "Ideja e një banke islame është ajo që i përmbahet principeve dhe orientimeve të investimeve islame",- deklaroi për Deutsche Welle-n në Frankfurt Zaid el-Mogadedi themelues dhe drejtor i Institutit për Financimin dhe Bankimin Islam (IFIBAF). Kjo bankë është paraqitur si një nga shpresat e shumta evropiane për t'u kyçur në një institut bankimi që ofron vetëm transaksione të mbështetura në asete të prekshme, se sa në menaxhimin spekulativ financiar, i cili ka shkaktuar krizën në vazhdim të euros. "Ju do të vëreni se në sistemin financiar islam ka gjithashtu mekanizma, që imitojnë efektin e normave të interesit- megjithatë nuk është e njëjta gjë",- thotë Martin Shulte ekspert i bankimit islam në Shoqatën e Bankave të Huaja në Gjermani. "Paraja vetë është e pafytyrshme, na duhet ta themi se vetëm të transferosh para nuk krijon vlerë ekonomike",- thotë ai. "Ajo është mjet shkëmbimi, e cila vetë nuk ka fuqi ekonomike. Bankimi konvencional megjithatë pjesërisht bazohet në konceptin, se të huazosh para është një shërbim në vetvete, që ia vlen të kompensohet. Por në të kuptuarin

islam është e mundur të zhvillosh produkte, që janë ekonomikisht të dobishme dhe e plotësojnë biznesin e bankimit konvencional nga perspektiva makro shumë mirë.

Islami i ndalon muslimanët nga kamata dhe të marrin e të japin borxh me interes. Institucionet financiare dhe bankare islame nuk mund të marrin e të japin me fonde, ku përzihen alkooli, bixhozi, pornografia, duhani, armët apo derri. Financimet në përputhje me shariatin merren rregullimin eqiradhënieve, blerjet e përbashkëta dhe marrëveshjet për shitjet, ose ortakëritë e ndryshme. Investitorët kanë të drejtën të dinë se si përdoren fondet e tyre dhe sektori mbikëqyret nga një bord i posaçëm dhe po ashtu nga një autoritet rregullator kombëtar. E futur pak vite më parë në vende të ndryshme evropiane ekspertët shpresojnë, se fondi i ri islam gjerman të ketë më tepër sukses se sa në Francë e Britani. "Pika më vendimtare do të jetë nëse bankat islame do të kenë një portofol produktesh më tërheqës dhe shërbimesh",- tha El-Mogadedi i Institutit për Financimin dhe Bankimin Islam (IFIBAF). Gjithashtu "nëse komunikimi do të jetë mjaft i qartë për t'i sjellë muslimanë e jo-muslimanë në bankë si një alternativë tërheqëse",- shton ai. Një studim i botuar më 2012 nga Stresman Institut e nxjerr, se "Financa Islame" ka falimentuar në vendet evropiane, sepse klientat muslimanë kanë një nivel të ulët të

ardhurash dhe për këtë potencial të ulët investimesh. Por El-Mogadedi thotë se falimenti i produkteve financiare islame në Evropë u rrëzua nga marketingu i keq. Pasi kishin qëndruar për vite ngurrues ndaj kësaj industrie në boom një fond investimesh konform Islamit u hap në Gjermani në maj 2012 nga manaxheri i aseteve malajziane të CIMB Principal. Fondi u aprovua nga Autoriteti Mbikëqyrës Financiar Gjerman (BaFin). Gjermania ka 3,8 deri në 4,3 milionë muslimanë, të cilët përbëjnë aty diku në 5% të popullsisë 82 milionëshe, sipas disa studimeve veritative. Targeti i financave të reja islame janë afërsisht 4 milionë muslimanët, së bashku me jo-muslimanët. Bankimi islam është një nga sektorët me rritjen më të shpejtë në botë. Produktet financiare islame e patën boom-in e tyre të parë pas sulmeve të 11 shtatorit në SHBA. Shumë arabë i tërhoqën paratë e tyre nga SHBA asokohe dhe disa nga këto fonde përfunduan në Malajzi dhe në vendet e Gjirit. Një boom i dytë u vërejt gjatë krizës financiare ndërkombëtare, kur produktet financiare islame treguan rritjen e përfitimave. Dow Jones Islamic Market Titans Index, i cili gjurmon 100 bizneset më të mëdha sipas Islamit në Evropë, SHBA e Azi thotë se gati i kanë dyfishuar fitimet në këto pesë vitet e fundit. Sistemi sipas shariatit tashmë po praktikohet në 50 vende në mbarë botën, duke e bërë atë një nga sektorët me rritjen më të shpejtë në industrinë

globale financiare. Në këto caste ka rreth 300 banka islame dhe institucione në mbarë botën asetet e të cilëve arrijnë në 1,6 trilionë \$ (1,2 trilionë euro).

<http://www.iinanews.com/en/index.php/economy/998-kuveyt-turk-to-open-first-islamic-bank-in-germany>

Egjipt, gazetarja e parë me shami jep edicionin e lajmeve

Për herë të parë që pas rrëzimit të ish presidentit Hosni Mubarak, një gazetare me shami u shfaq në ekran për të transmetuar edicionet informative. Me një shami ngjyrë kremi në kokë, dhe e veshur me kostum të zi, Fatma Nabil u shfaq në Channel 1 në pikun e shikueshmërisë. Televizionin publik ka bërë të ditur se ky është rasti i parë ku një femër me shami drejton edicionin informativ, pasi me parë ishte e ndaluar nga regjimi që të transmetoheshin indirekt mesazhe fetare dhe i cili donte të ruante laicitetin në televizionin shtetëror.

"Më në fund revolucioni u arrit", ka thënë për mediet e egjiptiane, Ministri i Informacionit, Salah Abdel Maqsud Nabil (Partia: Vëllezërve Myslyman). Sipas tij dalja e saj me shami duhet të shërbejë si shembull për femrat e tjera që dalin në transmetime televizive pa u mbuluar. Gjatë regjimit të Mubarakut, femrat me perçe punësoheshin në televizion por nuk shfaqeshin në ekran.

Qasje / DALJA JASHTË DYERVE TË XHAMISË PËR RITJEN E NDËRVEPRIMIT PUBLIK

Nga **Roland ZILI**

Pas më shumë se dy dekadash nga rënia e regjimit komunist, Feja Islame po përballet me një dinamikë të vullshme të zhvillimit ekonomik, politik, social, nacionalist, teknologjik e mediatik, çka po i detyron klerikët dhe në përgjithësi besimtarët të rishohin pozicionet për të kapur ritmet me të cilat ndryshon shoqëria. Aq më imediate bëhet nevoja për të qenë në të njëjtën gjatësi vale me këtë shpejtësi, për t'i përçarur shoqërisë mesazhin islam, në kushtet kur gjithandej, por veçanërisht në Tiranë, numri i besimtarëve praktikantë ka pësuar rritje të ndjeshme.

Ndryshe nga më parë ndërthurja në xhemat është më komplekse: ka një mazhorancë të moshave të reja, shumë adoleshentë e fëmijë, e sigurisht edhe të rritur apo të moshuar. Të gjithë ata praktikisht nuk e shohin më aktivitetin e përditshëm vetëm brenda dhe përreth xhamisë. Duke qenë pjesë e auditorëve në universitet, aktivistë të biznesit, medias, administratës e madje edhe të politikës, ky xhemat reflekton nevojën për hapësira të tjera të shfaqjes së besimit dhe aktivitetit fetar.

Në këto kushte, kur Komuniteti Musliman i Shqipërisë ndodhet shumë hapa pas vendit dhe rolit që duhet të ketë, çështja së cilës duhet t'i japin zgjidhje së pari drejtuesit fetarë e më pas Këshillat e Xhamive, është zhvillimi i raporteve të reja me shoqërinë, median, teknologjinë etj. Ata duhet të vendosin në themele më të plota, komunikimin jashtë objekteve të kultit, për të rritur ndërveprimin publik.

Nuk mund të thuhet, se në dhjetë vjeçarën e fundit hoxhallarët dhe xhematinukkaqenë në komunikim me publikun. Përkundrazi: shembuj të konceptimit të jetës fetare dhe shprehjes së besimit në dimensionin e tij real kanë qenë të shumtë, falë konsultimeve me elemente kompetente, si dhe pas impaktit të përfutur, për shkak të mbulimit mediatik.

Nëse dikur muslimanët ishin pjesë e dukshme e shoqërisë - përmes medias - vetëm në festat fetare, nga viti në vit kjo panoramë ka ndryshuar dhe shenjat kanë qenë pozitive. Duke nënvizuar disa prej tyre, risjell në vëmendje mbledhjen e firmave për njohjen e Pavarësisë së Kosovës, dërgimin e ndihmave humanitare për

banorët në fatkeqesi natyrore nga përmbytjet apo dëbora, dhurimi i përseritur i gjakut për të sëmuret në nevojë, përpjekjet e ndryshme për konsolidimin e të drejtave të njeriut në tërësi e të muslimanëve në veçanti, aktivizimi në debate publike mbi urbanizimin, çështjen e varrezave murale, homoseksualët, ambientin etj. E vërteta është se promotorë të këtyre aktiviteteve kanë qenë vetëm disa xhami brenda në qytetin e Tiranës, ku më së shumti peshon edhe mendimi dhe diskursi fetar.

Përkundër kësaj përvoje të vlefshme, klerikët, aktivistët dhe në përgjithësi xhemati kanë humbur shumë energji në përballet me Komunitetin Mysliman, i cili ka reflektuar në vijimësi një apati të dëmshme, duke tentuar të përthithë në përhumbjen e tij edhe këtë shfaqje vitale të besimtarëve dhe hoxhallarëve të rinj. Por ndonëse është shpenzuar kohë dhe energji, fatmirësisht nuk është humbur sensi i angazhimit publik të xhematit: çështja tashmë shtrohet që ai të zhvillohet në kompleks. Për këtë, së pari duhen identifikuar prioritetet e zhvillimit shoqëror. Ky proces në fakt, le për të dëshiruar tek hoxhallarët shqiptarë, e për rrjedhojë, edhe tek xhemati. Në shumë raste, angazhimi vjen si inerci apo spontanitet.

Por, si mund të rritet ndërveprimi publik?

Drejtuesit fetarë dhe konsulentët e tyre, duhet të shenjojnë dhe të njohin mirë zonën ku banojnë, specifikën e lagjes dhe banorëve, figurat e saj, nevojat dhe të mirat e mangësitë që disponon.

Klerikët nuk mund të qëndrojnë vetëm në xhami dhe të thirren nga jashtë për të shkuar në raste fatkeqësish apo gëzimesh në lagje, kur ata mund të vetëofrohen për shërbesa fetare.

Vizita dhe kontakti me persona të njohur të komunitetit që rrethon xhaminë s'ka sesi të jetë pjesë e rastësisë. Hoxhallarët identifikojnë personazhet publike dhe i bëjnë ata pjesë të kontakteve të tyre, i ftojnë në aktivitete dhe u marrin mendime të vlefshme për jetën e xhematit dhe përmirësimin social.

Hartimi i një liste me biznesmenët më të njohur të komunitetit, me mjekët, artistët, politikanët, drejtuesit vendorë etj, të cilët mund të bëhen pjesë e zgjidhjes së çështjeve të ndryshme, si për xhematin ashtu edhe për banorët, është një domosdoshmëri.

Krijimi i një regjistri për familjet

e varfra, jetimët dhe familjet që kanë probleme të mprehta sociale, i nxit hoxhallarët në shtimin e komunikimit ndihmës dhe impaktit publik.

Xhamisë, pra, i duhet dhënë roli i një qendre rreth së cilës marrin jetë jo vetëm besimi dhe shprehja e tij, por edhe ekonomia, arsimit, solidariteti, sporti, ambienti, prezantimi i qëndrimeve etj. Shpeshherë, hoxhallarët tanë i kemi parë të jenë pjesë e çështjeve madhore, si për shembull angazhimi për zgjedhjet e përgjithshme apo lokale, regjistrimi etnik e fetar i popullsisë, ndihmat humanitare etj. Këto thithin vëmendje publike, për shkak edhe të mbulimit të garantuar mediatik.

Por po aq e vërtetë është se një xhami e "profil lokal e social", e shkruar me jetën e banorëve mes të cilëve ndodhet, është shumë e suksesshme në ndikimin direkt në jetesën e familjeve. Thënë ndryshe, hoxhallarët "universalë" përballen gjithnjë me rrezikun e harresës së detajeve të përditshmërisë, nevojave reale e të vazhdueshme të njerëzve dhe protagonistëve të komunitetit.

Pjesëmarrja në jetën komunitare mund të arrihet edhe përmes angazhimit në rrafshin e pushtetit lokal. Mes anëtarëve të një xhamie ka protagonistë me aktivitet të spikatur politik. Për ta, duhet lobuar në vijimësi, që të jenë pjesë e listës së këshilltarëve apo edhe të stafeve të të zgjedhurve vendorë. E njëjta gjë duhet marrë në konsideratë edhe për pushtetin qendror. Orientimi i votës duhet parë si mundësi përfaqësimi të muslimanëve në strukturat e pushtetit dhe ushtrimit të tij.

Shndërrimi i xhamisë në një qendër të madhe e të rëndësishme të aktivitetit fetarë - social vitalizon jo vetëm xhematin, por edhe pjesë të shoqërisë, që ndodhen pranë tij. Klerikët drejtues dhe Këshillat e Xhamive duhet të hartojnë axhenda aktiviteteve komplekse. Veç mësimin të Kuranit dhe leksioneve fetare, është e rëndësishme të organizohen aktivitete të zgjeruara sportive, mini konkurse të dijes në bashkëpunim me shkollat, aksione pastrimi në bashkëpunim me Bashkinë apo Komunën, botime njohëse dhe shpërndarje materiale propagandistike, dhënie ndihmash familjeve në nevojë, prononcime publike - mediatike pro apo kundër, sipas rastit. Një shembull në këtë drejtim është nxjerrja e një çadme me materiale sensibilizuese në

formë fletushkash para fillimit të muajit të Ramazanit në dy pika ku ka lëvizje të madhe kalimtarësh nga Këshilli i Xhamisë së Kokonozit nën kujdesin e imamit të Xhamisë për t'i sensibilizuar njerëzit për fillimin e këtij muaji të madhërueshëm.

Rritja e ndërveprimi publik ka shanse maksimale edhe përmes shfrytëzimit të teknologjisë dhe aplikimit të teknikave të reklamimit. Interneti, rrjetet sociale, blogjet, spektri i gjerë mediatik, në fakt janë mjaft të përdorshme individualisht. Për fat të mirë, disa xhami kanë faqen e tyre në internet, ndërsa klerikët e aktivistët fetarë janë pjesë e diskutimeve on line.

Çështja është se faqet në internet të xhamive nuk e kanë fituar ende përmasën e një hapësire, ku nuk dominon natyralizmi fetar i jetës, por jeta "ideale" fetare. Shumë "lundruer" të internetit i identifikojnë këto si faqe fetare, duke iu kushtuar pak vëmendje. Çdo modifikim që e shndërron hapësirën në internet në një mundësi prezantimi për komunitetin e gjerë ku ndodhet xhamia, bëhet zëdhënës më i fuqishëm edhe i elementit fetar.


Ndërkohë në Shqipëri ka një sërë shoqatash jo-qeveritare apo organizimesh edhe me karakter fetar. Forumi Musliman i Shqipërisë, Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë, E-Zani i Naltë, si dhe disa shoqata të tjera të karakterit tradicional përbëhen kryesisht nga aktivistë praktikantë. Ato përbëjnë gjithashtu resurse të dobishme për klerikët dhe Këshillat e Xhamive në përcaktimin e agjendave të ndërveprimi publik.

Njerëzit jashtë xhamive, ata që nuk janë në rrethin e gjerë të besimit, por që ndoshta shprehin interes dhe ndajnë me besimtarët përditshmërinë e tyre, këta njerëz pra, kanë nevojë ta shohin drejtuesin fetar jo si protagonist të veçuar, por si një pjesëtar dhe protagonist aktiv të interesit të tyre. Këto kategori njerëzish nuk kanë nevojë për kritizime të përhershme, për shkak të çështjes së besimit, por për ndihmëtarë realë në çështjet e përditshmërisë, udhëzues dhe aktivistë solidarë.

* Ky shkrim është përmbledhje e një kumtese të mbajtur nga autori në seminarin e zhvilluar nga LSH me temë "Gjetja e rrugëve të komunikimit me shoqërinë e sotme", Tirane, qershor 2012

A.M.B.C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE



www.lidhjatregtareve.com



DYQANI I MISHIT "HALLALL"

- ✓ Tregton mish vici, qengji, qofte dhe sallameri të firmës "Meka", me shumicë dhe pakicë.
- ✓ Ofron qengja për kurbanë dhe akika.

Adresa: Rr. "Bedri Cullhaj", tek Goni, pranë Xhamisë së Kombinatit
 Tel: 04 2350569; Cel: 0672050070
 Email: agronxhepa@hotmail.com

DYQANI I MISHIT "HALLALL", Kombinat

PRODUKTE NATYRALE



Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



Jeni të mirëpritur!

Në dyqanin tonë do të gjeni:

- Produkte të firmës "Phenomenal"; vaj të farës së zezë (Habbe Seuda) etj.
- Vajra bimore të firmës "Tact" (mbi 70 lloje bimësh)
- Mjaltë nga lulja e farës së zezë, mjaltë me polen, mjaltë me qumësht blete, mjaltë sidri, etj.
- Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
- Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe shampo
- Vajra el-Bedil, përzierje vajore kundër rënies së flokut
- Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojllojshme
- Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
- Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
- Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar.
- Kohël bimor për sytë etj.

Adresa: Rr. e Kavajës, rrugica përballë xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë

Cel: 0672812607 / 0672821589